

**VENDIM**  
**Nr. 14, datë 3.3.2014**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SPAHIU - GJANÇ” SHPK NË AKTIVITETIN E  
TREGTIMIT  
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”; 9 dhe 13, pika 1 germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1 germa “g”; 5, pika 2 germa “f”; 13 dhe 14, pika 1, të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 3.3.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Spahiu-Gjanç” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Spahiu - Gjanç” sh.p.k plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave, si më poshtë:

Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4.10 gjerat “a”, “b” dhe “c”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të licencojë shoqërinë “Spahiu - Gjanç” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 20-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**